



REPUBLIKA KOSOVA / RÉPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

---

**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

---

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 06/l-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe nenit 29 paragrafi 1 të Rregullores MF-nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kryetari i Komunës së Gjiçanit nxjerr këtë:

**RREGULL I BRENDSHËM PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT**

**Neni 1**  
**HYRJE**

1. Komuna e Gjiçanit përmes Politikës për Menaxhimin të Rrezikut (tutje Rregulla), merr përsipër përbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në identifikimin, vlerësimin, zbutjen (mitigimin) dhe monitorimin e rreziqeve për të siguruar realizimin e objektivave të veta.
2. Rregulla është formulim deklarativ i qëllimeve të përgjithshme dhe drejtimit të Komunës së Gjiçanit lidhur me menaxhimin e rrezikut.

**Neni 2**  
**QËLLIMI**

1. Qëllimi i kësaj Rregulle është përcaktimi i parimeve, kërkesave dhe udhëzimeve për menaxhimin e rrezikut në Komunën e Gjiçanit.
2. Kjo Rregull, përshkruan konceptet themelore që janë bazë për përgatitjen e Procedurës Standarde të Operimit për menaxhimin e rrezikut në Komunë.
3. Rregulla është e zbatueshme në të gjitha njësitë organizative të Komunës së Gjiçanit.

### Neni 3 DEFINICIONET

1. **Korniza për Menaxhim të Rrezikut** – është një seri aktesh rregulluese dhe komponentësh, që sigurojnë themelet dhe aranzhimet organizative për planifikimin, zbatimin, monitorimin, rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të rrezikut në Komunë.
2. **Menaxhimi i rrezikut** - është proces i përgjithshëm i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve dhe zbatimit të kontrolleve të nevojshme për të mbajtur ekspozimin ndaj rrezikut në një nivel të pranueshëm. Kjo duhet të integrohet si pjesë e procesit të përgjithshëm të menaxhimit.
3. **Rreziku** - reflekton pasigurinë drejt arritjes së objektivave të subjektit. Ekspozimi ndaj rrezikut është kombinimi i probabilitetit (gjasës që do të ndodhë një ngjarje) dhe ndikimit të ngjarjes nëse kjo ndodhë.
4. **Apetiti ndaj rrezikut** - niveli i rrezikut të cilin subjekti është i gatshëm ta pranojë në mënyrë që të arrij objektivat e veta.
5. **Toleranca e rrezikut** - është niveli i pranueshëm i variacionit në lidhje me arritjen e objektivave;
6. **Ndikimi** – nënkupton efektin e një ngjarje jo të favorshme që do të ketë për arritjen e objektivave, nëse ngjarja ndodhë.
7. **Probabiliteti i shfaqjes** – nënkupton probabilitetin e një ngjarje të pafavorshme që do të ndodhë, në qoftë se nuk ka pasur aktivitete të kontrollit apo aktivitetet e kontrollit janë të pamjaftueshme.
8. **Incident** – një ngjarje rreziku që ka ndodh.
9. **Rreziku i qenësishëm (inheret)** – niveli i rrezikut në mungesë të kontrolleve.
10. **Rreziku i mbetur (residual)** – niveli i rrezikut pas implementimit të kontrolleve.
11. **Maturimi i proceseve të rrezikut** - aftësia e institucionit për të menaxhuar rreziqet vlerësohet në disa fusha: kultura e riskut, qeverisja e riskut, proceset e menaxhimit të riskut dhe kompetenca institucionale (aftësi, njohuri dhe përvojë).
12. **Pronar i rrezikut** - personi përgjegjës për menaxhimin e një rreziku të caktuar të lidhur me objektivin (et) që ai/ajo është përgjegjës.

### Neni 4 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

#### 1. Udhëheqësi i Komunës së Gjilanit

- 1.1 Siguron vendosjen e sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe zbatimin e veprimeve për zvogëlimin e rrezikut në mënyrë që të arrihen objektivat e Komunës.
- 1.2 Është përgjegjës për mjedisin e kontrollit të brendshëm, për të përcaktuar se sa rrezik mund të bartë subjekti (apetitin e rrezikut) dhe qasjen për zvogëlimin e rrezikut.
- 1.3 Është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të dokumentuar në kuadër të Komunës.
- 1.4 E cakton Menaxherin e Rrezikut.
- 1.5. Aprovon Procedurat Standarde të Operimit për Menaxhim të Rrezikut.

- 1.6 Merr veprime për implementim të rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm, Auditimit të Jashtëm dhe Komitetit të Auditimit për të përmirësuar proceset e menaxhimit të rrezikut në subjekt.
- 1.7 Ofron siguri tek palët e interesit se rreziqet janë duke u identifikuar, vlerësuar dhe zvogëluar (mitiguar).

## **2. Menaxheri i Rrezikut**

- 2.1. Menaxheri (Koordinatori) i Rrezikut në Komunën e Gjilanit, duhet që në baza tremujore dhe kurdo që kërkohet (ad hoc) i raporton Kryetarit të Komunës për MENAXHIMIN e rrezikut..
- 2.2. Është përgjegjësi e Menaxherit të Rrezikut që të sigurojë që analizat e menaxhimit të rrezikut të kryhen në periudhë të rregullt tremujore për të gjitha njësitë organizative të Komunës.
- 2.3. Konsolidon listat e rreziqeve të përditësuara të pranuar nga secila njësi në Regjistrin e Rrezikut si regjistër qendror me të gjitha rreziqet në Komunë.
- 2.4. Menaxheri i rrezikut duhet të ketë qasje në informacion rreth operacioneve dhe vendimeve në organizatë. E drejta për qasje në informacion relevant, definohet në përshkrimin e funksionit dhe mund të përfshijë p.sh. qasjen në sisteme të TI-së, dokumente, hapësirat fizike etj.
- 2.5. Menaxheri i rrezikut, kurdo që e shihet të nevojshme, ka të drejtë të merr pjesë në takime.

## **3. Udhëheqësit e njësive organizative**

- 3.1. Janë përgjegjës për identifikimin, matjen, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut. Procesi i vlerësimit të rrezikut koordinohet me Menaxherin e Rrezikut.
- 3.2. Janë përgjegjëse për mirëmbajtjen efektive të kontrolleve të brendshme.
- 3.3. Vlerësojnë, kontrollojnë dhe zvogëlojnë (mitigojnë) rrezikun, përmes zhvillimit dhe zbatimit të udhëzimeve, rregullave, politikave dhe procedurave të brendshme.
- 3.4. Përditësojnë listën e rreziqeve në baza tremujore dhe në fund të çdo tremujori listën e rreziqeve të përditësuara e dërgojnë te Menaxheri i Rrezikut.

## **4. Anëtarët e stafit**

- 4.1. Është përgjegjësi e të gjithë anëtarëve të stafit, që të respektojnë Rregullën për Menaxhim të Rrezikut dhe Procedurat Standarde të Operimit për Menaxhim të Rrezikut.
- 4.2. Të informojnë mbikëqyrësin e tyre dhe Menaxherin e Rrezikut nëse vihen në dijeni për ndonjë incident potencial si dhe për ato rreziqe që nuk mbulohet nga procedurat ekzistuese.

## Neni 5 PROCESI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT

1. Në baza tremujore dhe kurdo që është e nevojshme kryhet procesi i menaxhimit të rrezikut në Komunë sipas fazave:
  - 1.1. identifikimin e ngjarjeve që mund të ndikojnë arritjen e objektivave;
  - 1.2. analiza dhe vlerësimi i rrezikut lidhur me mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin;
  - 1.3. veprimet ndaj rrezikut me qëllim të shmangies, transferimit, pranimit, ndarjes apo zvogëlimit të rrezikut.
  - 1.4. monitorimin e zbatimit të veprimeve;
  - 1.5. raportimi i rregullt rreth profilit të rrezikut në (Subjekt)
2. Për zbatimin e fazave të menaxhimit të rrezikut në mbështetje të Politikës, zhvillohet dhe aprovet për implementim Procedura Standarde e Operimit për menaxhim të rrezikut.

Date: 06.08.2024

